



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.150, datë 01.04.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR  
NR. 84 DATË 04.03.2021 "PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS  
KANALIZIME TIRANË SH.A."

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 01.04.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 84 datë 04.03.2021 "Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.",

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë (**UK Tiranë**) me shkresat nr. 8647 prot. datë 25.05.2021 me lëndë "Mbi pajisjen e shoqërisë me Akt Miratime Higjiene Sanitare", nr. 4910 datë 11.03.2022 me lëndë "Kërkesë për modifikim licence" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**), për zgjerimin e zonës së shërbimit, Akt Miratimet Higjiene Sanitare, në të cilat përfshihen njësitë e tjera administrative Baldushk, Pezë, Farkë, Bërzhitë dhe Krrabë, që kishin mbetur jashtë zonës së shërbimit të kësaj shoqërie.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të zgjerimit të zonës së shërbimit të UK Tiranë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Tiranë me vendimin nr. 84 datë 04.03.2021“Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.” me një afat 2 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit si më poshtë:

1. Njësia administrative nr.1;
2. Njësia administrative nr.2;
3. Njësia administrative nr.3;
4. Njësia administrative nr.4;
5. Njësia administrative nr.5;
6. Njësia administrative nr.6;
7. Njësia administrative nr.7;
8. Njësia administrative nr.8;
9. Njësia administrative nr.9;
10. Njësia administrative nr.10;
11. Njësia administrative nr.11;
12. Njësia administrative Dajt;
13. Njësia administrative Kashar;
14. Njësia administrative Ndroq;
15. Njësia administrative Petrelë;
16. Njësia administrative Shëngjergj;
17. Njësia administrative Vaqarr;
18. Njësia administrative Zall Bastar;
19. Njësia administrative Zall Herr.

4. KKRR në vendimin nr. 84 datë 04.03.2021 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.” i rekomandoi shoqërisë UK Tiranë që të punonte në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë të të gjithë zonës së shërbimit me akt miratim higjieno – sanitar;

5. Akt miratimet higjieno sanitare për zonën e shtuar janë si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Njësitë Administrative që i shtohen zonës së shërbimit</b>	<b>Akt - Miratimi Higjieno – Sanitar</b>
1	Bërzhitë	Nr. 151, datë 10.05.2021 “Stacion Pompimi”
2	Farkë	Nr. 148, datë 10.05.2021 “Depo uji”
3	Baldushk	Nr. 746, datë 23.11.2021 “Stacion Pompimi”
4	Krrabë	Nr. 747, datë 23.11.2021 “Depo uji”
5	Pezë	Nr. 751, datë 25.11.2021 “Stacion Pompimi”, Grecë

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Tiranë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

## **VENDOSI:**

Në pikën 3 të vendimit të KKRR nr. 84 datë 04.03.2021 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.”, bëhen këto ndryshime:

*Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a është Bashkia Tiranë.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**Ndriçim Shani**